

KOMUNA RAHOVEC



BULETINI MUJOR KOMUNAL TETOR 2020

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT E KOMUNES / KABINET PRIDIEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1482 Nr. i faq/Br.str/No pg 149
Data/Datum/Date 12 / 11 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

PËRMBAITJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE	3
PËRFUNDIM	14

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin tetor ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec. Ai poashtu i njoftoi se së shpejti pritet të hapet edhe Objekti i ri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Emergjencia në Rahovec, gjë që do të lehtësojë punën e personelit të cilët pritet të punojnë në këtë objekt, si dhe do të ndikojë edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët të cilët shërbimet shëndetësore i marrin në këtë qendër mjekësore.



Në Sallën e Kuvendit, në një takim me Ekipin Komunal për Planifikim, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe kompania e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, kanë bërë prezantimin e punës së deritanishme të procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit.

Është nënshkruar kontrata për ndërtimin e rrugëve lokale në komunën e Rahovecit. Projekti "Ndërtimi i rrugëve lokale" është bashkëfinancim i komunës së Rahovecit dhe MPL-së dhe ndahet në tre lote:

1. LOT I- 337,408.33 euro, (6995 metra rrugë në 8 vendbanime),
2. LOT II- 262,463.50 euro, (5730 metra rrugë në Rahovec dhe 8 vendbanime),
3. LOT III- 275,674.82 euro (5105 metra rrugë dhe 5 vendbanime).



Bashkë me drejtoreshën e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka, Kryetari, z.Smajl Latifi ka pritur për vizitë ministren e MKRS-së, znj.Vlora Dumoshi dhe zv.ministrin z.Halil Matoshi, me të cilët bashkëbiseduan për projektet e përbashkëta që ka MKRS-ja dhe Komuna e Rahovecit, në fushën e trashëgimisë e të rinisë si dhe investimet kapitale në kulturë dhe sport.



Kryetari Latifi ka mbajtur takim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit. Gjatë takimit diskutuan për performancën komunale, poashtu i informoi kryetarët e fshatrave dhe lagjeve se buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2021 është miratuar me kohë, e buxheti për vitin 2021 do të jetë më i vogël, shkaku i shkurtimeve që kanë ardhur si pasojë e pandemisë Covid-19.



Kryetari Latifi ka nënshkruar memorandum të rëndësishëm bashkëpunimi me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, z.Blerim Kuçi. Ky bashkëpunim ka rëndësi të madhe për komunën e Rahovecit, sepse përfshin furnizim me pajisje të TI-së, për shkolla të komunës sonë. MEA, do të financojë me 10,000 euro, ndërsa komuna e Rahovecit, do të financojë këtë projekt përtej shumës së financuar nga MEA.



Kryetari, z.Smajl Latifi ka pritur për vizitë Komandantin e Komandës Regjionale- Perëndim, Kolonel Gianluca Figus, bashkë diskutuan për situatën dhe ndikimin e pandemisë Covid-19, situatën politike e gjendjen e përgjithshme të sigurisë. Poashtu, diskutuan edhe për projektet komunale dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes KFOR-it dhe Komunës së Rahovecit.



Pas përpjekjeve të vazhdueshme dhe insistimit të komunës së Rahovecit ka filluar ekzekutimi i pagesave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, për periudhën: janar-qershor në Komunën e Rahovecit!



Kryetari Latifi ka nënshkruar kontratat për mbështetje financiare për 6 OJQ, që zhvillojnë aktivitetet në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, në vlerë të përgjithshme prej 8 mijë e 100 euro.



Së bashku me drejtorin e arsimit z. Avni Morina, Kryetari, z. Smajl Latifi ka pritur në takim drejtorin menaxhues të Fondit të Kosovës për Eficiençë të Energjisë z. Admir Shala. Me z. Shala nënshkruan marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projekteve për ndërmarrjen e masave të energjisë eficiente edhe për dy objekte shkollore në komunën tonë. Shkollat përfituese të përfshira në këto projekte, janë:

- Shkolla "Isa Boletini" në Rahovec
- Shkolla "Bekim Sylka" në Rahovec.



BUJQËSIA JONË E RILINDUR - 16 KOMORE FTOHËSE DHE 39 LAKTOFRIZË DO TË SHPËRNDAHEN PËR BUJQIT RAHOVECAS

Është publikuar lista e përfituesve nga thirrja për aplikim, për mbështetje të fermerëve ku prej tyre kanë përfituar gjithsej:

* 16 komore ftohëse (11 copë 25m³ dhe 5 copë 40m³) * 39 laktofrizë (26 laktofrizë 300 L dhe 13 laktofrizë 500 L).



6000 EURO DONACION NGA KFOR-i ITALIAN

Gatishmërinë për të shtyer përpara proceset të cilat rrisin sigurinë e qytetarëve, KFOR-i italian e ka dëshmuar në mënyrë të vazhdueshme, edhe kësaj radhe me dhurimin e donacionit për komunën e Rahovecit, që kap vlerën prej 6000 euro dhe përfshin vendosjen e rrjetit të ndriçimit publik në rr. "Vëllezërit Haradinaj" në qytetin e Rahovecit.



Bashkë me gra e vajza, burra e djem nga Rahoveci, përmes një aktiviteti simbolik të organizuar nga DSHMS në bashkëpunim me DKRS-në, u solidarizuar me qindra e mijëra gra e vajza, anë e mbanë globit, të cilat janë prekur nga kanceri i gjirit. Muaji tetor është muaji i dedikuar luftës kundër tumorit më të përhapur sot tek gratë, që është kanceri i gjirit. Investimi në preventivë është mënyra më efektive e luftimit të kësaj sëmundjeje, andaj edhe Drejtoria për Shëndetësi në komunën e Rahovecit ka planifikuar blerjen e një mamografi mobil.



Drejtori i DBPZHR-së, z.Berat Duraku së bashku me stafin e kësaj drejtorie ka pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë "Euro Tar" nga Turqia, me të cilët bashkë diskutuan lidhur me problemin e dëmeve në kulturat bujqësore si pasojë e ngricave të vonshme. Nga ana e përfaqësuesve të kësaj kompanie u prezentua edhe sistemi i avancuar i kësaj kompanie, sistem ky i cili ka për qëllim shtrirjen e sistemit për ujitjen e produkteve, plehërimin e tyre si dhe ruajtjen nga ngricat.



Komuna e Rahovecit përmes Zyrës për Shërbime Këshillimore e cila operon në kuadër të DBPZHR-së, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë kanë zhvilluar aktivitetin e radhës me marrjen e mostrave për analizat e tokës.



Në kuadër të projektit "Nxitja e bashkëpunimit dhe dialogut ndërkulturor, në kuadër të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor në komunën e Rahovecit", OJQ "Hardh Fest" ka organizuar Ekspoziten "Objektet e trashëgimisë kulturore në Rahovec". Ky projekt ka për qëllim të shtojë tolerancën dhe mirëkuptimin në mes komuniteteve, veçanërisht në mesin e të rinjve, dhe të nxjerr në pah rëndësinë e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në komunën e Rahovecit.



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, çdo herë ka shprehur dëshirë dhe gatishmëri për të përkrahur projekte me ide kreative, që kanë për qëllim aktivizimin e të rinjve. Kësaj radhe, drejtoresha e DKRS-së zojsh. Bjondina Kleqka bashkë me përfaqësuesin e OJQ "Iniciativa Pozitive" z. Destan Kerçagu, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, për një organizim sa më të sukseshëm të garës 3x3 Streetball, në qytetin e Rahovecit.




Rregullimi i zheshtores në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec.

Hapësira do të jetë në funksion për grupet kulturore dhe artistike, të cilët do të përformojnë në skenën e këtij objekti kulturor.



Shumë spektakël në aktivitetin atraktiv e sportiv "Streetball Kokrra" ne Rahovec.

Aktiviteti është përkrahur nga Komuna e Rahovecit, përkatësisht DKRS, dhe është organizuar nga Iniciativa Pozitive, duke prezantuar shumë veçori atraktive në kuadër të këtij organizimi.



Ka mbetur edhe pak kohë, drejt finalizimit të punimeve në fushën sportive në Dejnë.



Pamjet nga realizimi i punimeve të fazës së parë në lagjen "Patok" të Rahovecit.



Vazhdon projekti i zgjerimit të ndriçimit publik në qytetin e Rahovecit!

✓ Në përfundim të instalimit nëntokësor janë në rrugën "Bekim Isma",

✓ Vazhdojnë punimet edhe në disa segmente rrugore, si rrugën "Vaçe Zela" si dhe rruga tek Gjimnazi dhe lagje tjera sipas nevojës!



Intervenime emergjente në fshatin Kramavik!

Një problem i kahmotshëm i rrjedhave ujore të ujërave të zeza, është zgjidhur falë intervenimit emergjent nga kompania e kontraktuar e komunës së Rahovecit



Filluan punimet në zgjerimin e rrjetit të ujërave fekele në mes dy vendbanimeve të fshatit Drenoc dhe Senoc!

Vazhdojmë.....!



Ka filluar ndërtimi dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Vrajakë, që është pjesë e projektit "Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit" - LOT - I.

Të pranishëm në fillimin e punimeve ishin Kryetari Smajl Latifi dhe drejtori i arsimit Avni Morina, që njëherit është nga ky vendbanim. Do të vazhdojmë pastaj me realizimin e këtij projekti edhe në lokalitete të tjera.

Urime qytetarëve të Vrajakës!



Kanë filluar punimet në instalimin e ndriçimit publik në fshatin Çifllak!



Një intervenim emergjent është bërë në fshatin Gexhë!

Është bërë ndërhyrje në rrjetin e ujërave fekale në gypin kryesor të rrjetit të kanalizimit.




Vazhdon zgjerimi i rrjetit të ujërave fekale në fshatin Brestoc.



Infrastruktura publike, në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve!

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka zhvilluar disa punime në qytet, intervenime të domosdoshme pas deformimeve në rrugë, sidomos në përmirësimin e ujëmbledhsëve!



Komuna e Rahovecit, në vazhdimësi është e angazhuar në eliminimin e deponive inerte në bashkëpunim me kompanitë si Mendi P, Topalli, EEA Njaz, Bamirs, të cilët vullnetarisht janë angazhuar në mirëmbajtjen e hapësirave publike, duke eliminuar 10 deponi inerte në territorin e komunës sonë.



Filloi asfaltimi i rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc, një projekt i bashkëfinancuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe komuna e Rahovecit!



Intervenimet në rrjetin e ujërave fekele në fshatin Hoqë e Vogël.



Kanë filluar punimet në zgjerimin e rrjetit të ujërave fekale në fshatin Nashpall!



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e objektit të ri të shkollës "Liria" në Fortesë dhe sallës së edukatës fizike, projekt ky i financuar nga komuna jonë.

Këto ditë po punohet në ndërtimin e kulmit dhe punët po ecin në përputhje me dinamikën e paraparë të projektit



Pas nënshkrimit të kontratës Lot - I për riparime në shkollë, operatori menjëherë ka filluar punimet. Këto ditë po bëhet riparimi i nyjeve sanitare në shkollën "Katër Dëshmorët" në Ratkoc, për të vazhduar pastaj edhe në 7 objekte të tjera shkollore.




Në këto ditë me mot të mirë po vazhdojnë punimet në ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe. Këto ditë po punohet në ndërtimin e kulmit.



Te çerdhja e re në ndërtim në Ratkoc po zhvillohen punime në rregullimin e oborrit.



Vazhdon dezinfektimi i rregullt i objekteve shkollore në të gjithë komunën



Interesimi për Konkursin Ndërkombëtar për Dizajnimin e Sheshit Qendror të Rahovecit, është shumë i madh. Një artikull të veçantë shpalljes së konkursit nga ana e Komunës së Rahovecit, i ka kushtuar edhe njëra nga revistat më të vjetra në botë për arkitekturë "The Architectural Review", e themeluar në vitin 1896 në Londër.

Ndërkohë, afati i fundit për aplikim është 16 nëntori 2020



Punimet e ndriçimit në parkun e ri në qendër të fshatit Ratkoc!



Punimet në Optrushë. Filluan para një muaji, do të përfundojnë pas një muaji!



Me propozim të kryetarit të Komunës z.Smajl Latifi, dhe me përkrahjen e kuvendarëve bëhet lirimi nga qiraja (objektet komunale dhe lokaleve afariste) për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2020 në komunën e Rahovecit. Lirimi nga qiraja mujore sipas këtij vendimi vlen për të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme komunale të cilët kanë kontrata për shfrytëzimin e objekteve komunale dhe lokaleve afariste që janë pronë e Komunës së Rahovecit.



700 fermerë rahovecas përfitojnë mekanizëm bujqësor. Mekanizmat bujqësor që do të shpërndahen janë: Motokultivatorë, spërkatësë, frezë, plugje dy krahësh, kultivatorë, frezë, mulqere për hardhi, shpërndarësë plehu, makina mjelëse dhe pompë për ujitje.

PËRIFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (tetor 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, nëntor 2020